



Pranuar / Dorezuar Pritiljeno/Prudato Received/Delivered	09.12.2020	0	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinstvo Org./Unit	3049/2020	Shtjega Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
			1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.337/2020

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.337/2020 të datës 28/10/2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi fshati Astrozup, KK-Malishevë, kundër Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Malishevës me nr.01/870 të datës 29.09.2020, në çështjen juridike "kompesim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.337/2020 e datës 28.10.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].**
- II. Mbetet në fuqi** Aktvendimi i datës 29.09.2020 me nr,protokolli 01/870 të Kryetarit të Komunës së Malishevës.
- III. Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.**

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], i punësuar në bazë të Aktvendimit të datës 05.09.2018 me nr.protokolli 01/1277 në pozitën "Zyrtar i Lartë për menaxhimin e mbeturinave, në Drejtorin për Shërbime Publike, është caktuar nga kjo Drejtori për pjesëmarrje në një trajnim në Japoni prej datës 07.07.2019 deri më datën 07.09.2019. Të gjitha shpenzimet me përjashtim të mëditjeve janë të mbuluara nga organizatorët e trajnimit. Me datën 21.06.2019 Kryetari i Komunës së Malishevës mori aktvendim me nr.protokolli 01-873 me të cilin i lejohen mjetet financiare prej 900.00.€ në emër të mëditjeve me rastin e vizitës zyrtare në Japoni për tetëmbëdhjetë (18) ditë. Ankuesi pas kthimit nga trajnimi i mbajtur në Japoni me datën 30.09.2019 ka parashtruar kërkesë me numër

protokolli 01/1253 për mbulimin e shpenzimeve të mëditjeve edhe për 49 ditë të qëndrimit në Japoni në shumën prej 2450 euro.

Ankuesi pasi që nuk ka marrë përgjigje nga Kryetari i Komunës së Malishevës me datën 04.09.2020 ka bërë prapë kërkesën me nr. protokollin 01/870 për Kryetarin e Komunës për mbulimin e shpenzimeve për ditët tjera sa ka qëndruar në Japoni. Kryetari i Komunës së Malishevës me Aktvendimin e datës 29.09.2020 me nr,protokolli 01/870 ka refuzuar kërkesën e ankuesit si të pabazuar.


I pakënaqur me . me Aktvendimin e datës 29.09.2020 me nr,protokolli 01/870 të Kryetarit të Komunës së Malishevës më datë 28/10/2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollin 2313/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03/11/2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Malishevës. Komuna e Malishevës më datë 16/11/2020 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollin 2313/2020 të datës 28/10/2020 e parashtruar nga ankuesi përmesë përfaqësuesit ligjor avokatit Nuhi Krasniqi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kopja e letërnjoftimit, Vendimi me nr.30/2018 i datës 19.06.2018 i Ministrisë së Financave, Kërkesë e datës 26.06.2019 për udhëtim zyrtar prej datës 04.07- 08.09.2019, Kërkesë për avanc për ndjekjen e trajnimit e datës 06.06.2019, kopja e vizës e datës 21.06.2019, Çertifikatë e datës 06.09.2019, Çertifikatë e datës 10.09.2019, Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve e datës 30.09.2019, Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve e datës 04.09.2020, Aktvendim i Kryetarit të Komunës i datës 21.06.2019, Aktvendimi i Kryetarit të Komunës i datës 29.09.2020 me nr.01/870, Kopja e Rregulloresë nr.33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, Aktvendim i datës 05.09.2018, Aktvendim i datës 05.12.2014, Akt emërimi i datës 11.01.2012 me nr.01.05 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 16.11.2020 bashkë me shkresat e lëndës.,

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [REDACTED] [REDACTED], është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi, kërkesën me numër protokollin 01/870 për mbulimin e shpenzimeve e ka bërë me datën 04.09.2020 për Kryetarin e Komunës së Malishevës për pagesën e mëditjeve prej 2450 euro, ndërsa Kryetari i Komunës së Malishevës me Aktvendimin e datës 29.09.2020 me numër protokollin 01/870 ka refuzuar kërkesën e z. [REDACTED] me arsyetimin se z. [REDACTED] gjatë qëndrimit në Japoni parashtruesit të kërkesës nuk ju ka ndërprerë paga mujore edhe pse i njëjti nuk ka qenë në vendin e punës. Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se kërkesa e ankuesit është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili ka përcaktuar se "Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat nga



marrëdhënia e punës, , si dhe jashtë afatit të paraparë me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka përcaktuar se: *“Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”*, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton që ankuesi në Japoni ka qëndruar prej datës 04.07.2019 deri më datën 08.09.2019 në trajnimin “Avancimi i teknologjisë për menagjimin e mbeturinave Inerte (teknikat e avancuara). Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi kërkesën për mbulimin e shpenzimeve e ka parashtruar te Kryetari i Komunës me datën 04.09.2020 parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe jashtë afatit të paraparë me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda numër A.nr.337/2020 datë 09.12.2020

Sabile Avdyli
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit; [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

